

V E N D I M
Nr.2, datë 26.1.1995

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë e përbërë nga:

Rustem Gjata,	Kryetar i Gjykatës Kushtetuese
Manol Konomi,	Anëtar i “““
Hilmi Dakli,	Anëtar i “““
Franc Jakova,	Anëtar i “““
Alfred Karamuço,	Anëtar i “““
Zija Vuci,	Anëtar i “““
Metush Saraçi,	Anëtar i “““
Veli Budo,	Anëtar i “““

me sekretare Drita Filto, më datat 9.1.1995 dhe 26.1.1995, mori në shqyrtim në seancë gjyqësore me dyer të hapura çështjen Nr.14/3 Akti që i përket :

K Ë R K U E S: KOMITETI KOMBËTAR I VETERANËVE TË LUFTËS ANTIFASHISTE NACIONALÇLIRIMTARE, i përfaqësuar nga Mëhill Doçi dhe Nikoll Kolaj.

PERSON I INTERESUAR: KESHILLI I MINISTRAVE, i përfaqësuar nga Alfred Moisiu dhe Remzi Kruja.

O B J E K T I:

Shfuqizimi si antikushtetues i pikave 1 e 5 të vendimit të Këshillit të Ministrave nr.393, datë 8.8.1994, duke parashtruar:

1. Në shkronjën “a” të pikës 1 të vendimit parashikohet se përfaqësuesi i Ministrisë së Mbrojtjes kryeson Komisionin Organizues Qendror. Në këtë mënyrë vihet nën tutelë organizata e veteranëve. Me dhënien Ministrisë së Mbrojtjes të kësaj kompetence shkelet dispozita kushtetuese që e përcakton këtë Ministri si institucion të depolitizuar.

2. Në pikën 5 të vendimit të sipërm urdhërohen organet e pushtetit lokal të mos lejojnë që paralel me veprimtarinë zyrtare për të njëjtin përkujtimor, të zhvillohen aktivitete të tjera nga subjekte të ndryshme. Ky urdhërim është antiligjor dhe antikushtetues, sepse cënon kompetencat e pushtetit lokal dhe kërkon të kufizojë ose të ndalojë veprimtari të organizatës së veteranëve të mbështetura në akte të ligjshme.

GJYKATA KUSHTETUESE, pasi dëgjoi relacionin përkatës,

V Ë R E N:

Me vendim të Këshillit të Ministrave nr.562, datë 6.12.1993 “Për festimin e krijimit të strukturave të armëve dhe shërbimeve të Forcave të Armatosura”, është vendosur të përkujtohen me ceremoni ushtarake ditët e krijimit të armëve dhe shërbimeve të Forcave të Armatosura dhe është ngarkuar Ministria e Mbrojtjes në bashkëpunim me organet e pushtetit lokal të organizojë përkujtimin e krijimit të formacioneve të mëdha ushtarake. Ky vendim është ndryshuar dhe plotësuar me vendimin e Këshillit të Ministrave nr.393, datë 8.8.1994, në të cilin është parashikuar mënyra e organizimit të kremtimit të përkujtimorëve të formacioneve të mëdha luftarake e të festave lokale që lidhen me traditat luftarake, si dhe detyrat e organeve të pushtetit lokal për mbarëvajtjen e festimeve.

Sipas pikës 1 të këtij vendimi, kremtimi i përvjetorëve të formacioneve të mëdha luftarake bëhet nën drejtimin e Ministrisë së Mbrojtjes. Ajo ngarkohet të ngrejë Komisionin Organizues Qendror ku krahas përfaqësuesit të Ministrisë së Mbrojtjes si kryesues, marrin pjesë një përfaqësues i pushtetit lokal dhe nga një përfaqësues të organizatave të veteranëve. Ndërsa në pikën 5 të tij u vihet detyrë organeve të pushtetit lokal që të mos lejojnë të zhvillohen veprimtari të tjera paralele me veprimtarinë zyrtare për të njëjtin përkujtimor nga subjekte të ndryshme.

Pretendimi se me pikën 1 shkronja “a” të vendimit të sipërm organizata e veteranëve vihet nën tutelë, është i pabazuar. Në këto festime me karakter zyrtar patjetër që do të kryesojë organi shtetëror përkatës i ngarkuar me një akt juridik. Në të kundërtën nuk mund të organizohen kremtime të tilla në mënyrë unike dhe me ceremoni ushtarake. Organizatat e veteranëve u është njohur e drejta për të dërguar përfaqësues në Komisionin Qendror të Festimit. Kjo e drejtë e pjesëmarrjes në komision nuk do të thotë vënie nën tutelë. Përkundrazi, me këtë shprehet mundësia që i jepet asaj të marrë pjesë aktive së bashku me subjektet e tjera shtetërore e shoqërore në përgatitjen e festimit me karakter të përgjithshëm ose lokal.

Detyra që i ngarkohet Ministrisë së Mbrojtjes për të ngritur dhe drejtuar Komisionin Organizues Qendror të Festës, nuk e ndryshon aspak karakterin e saj si organ i depolitizuar, pasi vetë festat e armëve e shërbimeve të Forcave të Armatosura dhe të formacioneve të ndryshme luftarake, kanë karakter thjesht kombëtar.

Përsa i përket pretendimit tjetër se urdhërimi i organeve të pushtetit lokal shkel të drejtat kushtetuese të këtyre organeve, Organizata e Veteranëve të Luftës Antifashiste Nacionalçlirimtare nuk legjitimohet ta ngrejë. Ajo si person juridik, në bazë të nenit 25 të ligjit nr.7561, datë 29.4.1992 “Për disa ndryshime e plotësime në ligjin nr.7491, datë 29.4.1991 “Për dispozitat kryesore kushtetuese”, “ka të drejtë të bëjë kërkesë vetëm për të drejtat e saj kushtetuese. Megjithatë, gjykata e quan të nevojshme të verë në dukje se me detyrat që u ngarkohen organeve të pushtetit lokal me vendim të Këshillit të Ministrave, për marrjen e masave organizative dhe për moslejimin e veprimtarive paralele me veprimtarinë zyrtare për të njëjtin përkujtimor, synohet vetëm të sigurohet organizimi i festimit dhe marrja e masave të nevojshme për mbarëvajtjen e tij, duke parandaluar çdo veprimtari paralele, të veçuar nga ajo zyrtare, pasi ato mund të çonin në konfrontime të ndryshme dhe të dëmtonin rëndë karakterin edukues kombëtar të këtyre festave përkujtimore.

PER KETO ARSYE ,

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në bazë të neneve 24 pika 3 e 9 dhe 25 të ligjit nr.7561, datë 29.4.1992 “Për disa ndryshime e plotësime në ligjin nr.7491, datë 29.4.1991 “Për dispozitat kryesore kushtetuese”, me shumicë votash,

V E N D O S I:

Rrëzimin e kërkesës.

Ky vendim është përfundimtar dhe i formës së prerë.

Votoi kundër këtij vendimi zoti Veli Budo.

Tiranë, më 26.1.1995

MENDIMI I PAKICËS

Jam kundër vendimit të shumicës. Arsyet përse po i radhis më poshtë:

Në vendimin e Këshillit të Ministrave nr.562, datë 6.12.1993, ashtu siç është titulluar, urdhërohet të përkujtohen me ceremoni ushtarake ditët e krijimit të armëve dhe shërbimeve të Forcave të Armatosura, duke përcaktuar po aty, llojin e armës dhe të shërbimit si dhe kohën.

Me vendimin e Këshillit të Ministrave nr.393, datë 8.8.1994 “Për disa ndryshime në vendimin e Këshillit të Ministrave nr.562, datë 6.12.1993 “Për festimin e krijimit të strukturave të armëve dhe shërbimeve të Forcave të Armatosura”, në pikën 3 të tij përfshihen edhe festat për përkujtimin e krijimit të forcave të mëdha ushtarake, brigada, regjimente, divizione e korparmata dhe festat lokale që lidhen me traditat luftarake, siç janë : krijimi i çetave, batalioneve, zhvillimi i luftimeve e betejave luftarake, të parat, bëhen nën drejtimin e Ministrisë së Mbrojtjes në bashkëpunim me organet e pushtetit lokal dhe, të dytat, nga organet e pushtetit lokal, në bashkëpunim me njësitë e repartet ushtarake, si dhe me shoqatat me karakter patriotik dhe historik.

Në këtë vendim ngarkohen ministri i Mbrojtjes dhe organet e pushtetit lokal të krijojnë komisione të posaçme për festimin e këtyre kujtimorëve, por edhe vihen detyra për të siguruar mjete dhe për të përballuar shpenzimet e nevojshme.

Po në atë vendim jepet porosi e veçantë që në këto komisione e organizime të ftohen për të marrë pjesë edhe përfaqësues të organizatave të veteranëve dhe të shoqatave me karakter patriotik e historik.

Megjithatë, këta përfaqësues që ftohen të marrin pjesë, nuk janë të detyruar në këtë. Ata mund të marrin dhe mund të mos marrin pjesë në to.

Kuptohet vetvetiu se duke mos marrë pjesë në to, ata nuk do të mund të përfitojnë favorët e caktuara për këto raste nga shteti.

Të gjitha llojet e armëve dhe shërbimeve që urdhërohet të përkujtohen me ceremoni ushtarake bëjnë pjesë edhe sot e kësaj dite në efektivin e Forcave të Armatosura të vendit tonë, paçka se në shumicën e tyre mund të mos ketë asnjë person nga ata që dikur kanë marrë pjesë në krijimin e këtyre armëve dhe shërbimeve të Forcave të Armatosura.

Duke i dhënë karakter zyrtar festimit të përkujtimorëve lokalë, të krijimit të formacioneve luftarake dhe të ngjarjeve e betejave historike, del e qartë se shteti për këto raste është interesuar në mënyrë të veçantë, duke nderuar kështu edhe Luftën Antifashiste të popullit shqiptar, duke u dhënë atyre po kështu karakter mbarëkombëtar.

Por, siç duket një gjë e tillë, në kushtet e tanishme

paraqitet e vështirë mbasi lufta kundër pushtuesve nazifashistë dhe bashkëpunëtorëve të tyre është zhvilluar në rrethana e kushte të veçanta, të cilat kanë lidhje me grupimet e ndryshme të krijuara në vendin tonë gjatë Luftës së Dytë Botërore mbi bazë e qëndrime politiko-ideologjike, që kanë lënë mbresa dhe ushtrojnë ndikimin e tyre edhe sot e kësaj dite në individë të veçantë.

Si pasojë e kësaj, festimi i një ngjarje përkujtimore mund të kërkohet të festohet si e tillë nga një grup veteranësh, kurse për të mund të mbahet një qëndrim i kundërt nga një grup tjetër veteranësh etj. Në këtë çështje duhet patur parasysh kurdoherë se një numër i konsiderueshëm pjesëmarrësish të ngjarjeve të asaj kohe jetojnë akoma.

I qëndroj mendimit se zgjidhja dhënë kësaj çështje në pikën 5 të vendimit të dytë të Këshillit të Ministrave, në të cilën disponohet se organet e pushtetit lokal të mos lejojnë që paralel me veprimtarinë zyrtare, për të njëjtin përkujtimor, të zhvillohen veprimtari të tjera nga subjekte të ndryshme, nuk është racionale.

Mendoj se çështje të kësaj natyre zor se mund të gjejnë zgjidhjen e duhur duke vënë në përdorim forcën.

Nga ana tjetër, duke vendosur në këtë mënyrë, Këshilli i Ministrave mendoj bie ndesh me nenet 1, 2 e vijues të dekretit nr.7408, datë 31.7.1990 “Për mbledhjet, grumbullimet dhe manifestimet e shtetasve në vende publike”, si dhe bën të pavlefshëm në këto raste, përmbajtjen e paragrafit të parë të nenit 21 të ligjit nr.7692, datë 31.3.1993 “Për një shtojcë në ligjin nr.7491, datë 29.4.1991 “Për dispozitat kryesore kushtetuese” si dhe të ligjit “Për të drejtat dhe liritë themelore të njeriut”.

Në shtetin tonë demokratik, cildo person, vetëm apo me të tjerë, një grumbull personash apo organizata shoqërore të njohura ligjërisht, kanë të drejtë të organizojnë manifestime, grumbullime, si dhe mbledhje në përputhje me programet dhe statutet e tyre të miratuara nga organet kompetente shtetërore dhe sipas rregullave të përcaktuara në dekretin “Për mbledhjet, grumbullimet dhe manifestimet e shtetasve në vende publike”. Këto mbledhje mund të organizohen për çështje nga më të ndryshmet, duke përfshirë këtu edhe ato të karakterit historik, përkujtimor, mbledhje solemne apo me tematikë shkencore etj., të cilat mund të organizohen në bashkëpunim me organet shtetërore, me organizata të tjera shoqërore apo edhe me nismën e tyre. Vetë fjala “paralel” le shteg për interpretime nga më të ndryshmet dhe së fundi rreziku i konfrontimeve sociale është shumë më i mundshëm në rastet kur organet e pushtetit lokal, gjatë veprimtarisë së tyre zyrtare për të përkujtuar një festë lokale që lidhet me traditat luftarake, do të ndërhyjnë për të ndaluar një organizatë shoqërore apo një grup personash, të cilët në mënyrë private, në të njëjtën kohë, por në një vend tjetër, festojnë të njëjtin përkujtimor, duke respektuar dispozitat e dekretit “Për mbledhjet, grumbullimet dhe manifestimet e shtetasve në vende publike”.

Në këtë mënyrë pika 5 e vendimit në fjalë, përfundimisht, kufizon një nga llojet e tubimeve paqësore dhe pa armë, për të cilat paragrafi i parë i nenit 21 të ligjit “Për të drejtat dhe liritë themelore të njeriut”, shprehet se “nuk mund të kufizohen”.

Kështu që kërkesa për shpalljen antikushtetuese të pikës 5 të vendimit nr.393, datë 8.8.1994 të Këshillit të Ministrave, duhej pranuar.

Tiranë, më 26.1.1995

